



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 311 Prot.

Tiranë më 1. 12. 2016

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 01.12.2016 në orën 15:00, në ambientet e Kryeministrisë, u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Rendi i ditës, sipas njoflimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren mbi Procedurat e Financimit me Grante në mbështetje të Shoqërisë Civile”
2. Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme të AMSHC-së (shtojcë në lidhje me integrimin e strukturës së KKSHC-së)
3. Hapja e periudhës së konsultimit për thirrjen e radhës.

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC-së z. Andi Kananaj, si edhe anëtarëve të Bördit si më poshtë :

1. Z. Adrian THANO
2. Znj. Majlinda DHUKA
3. Z. Aldo MERKOçi
4. Z. Endri FUGA
5. Znj. Kozara KATI

Kryetari i BM, z. Adrian Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur rmbledhjen rrëth orës 15:00.

Menjëherë Kryetari pasi përmend rendin e ditës i jep fjalën Drejtorit Ekzekutiv, z. Andi Kananaj i cili, pasi përshëndet shprehet se: “Gjatë punës jemi hasur me disa momente që janë parë si të vështira për t'u vënë në zbatim ashtu si janë përcaktuar në rregullore, ndaj jemi fokusuar më tepër në rregullimin e disa neneve dhe pikave. Gjithashtu duke parë nevojën dhë hapësirat nc kemi mbështetur krijimin e një strukture të vogël të KKSHC-së ndaj formalisht dhe zyrtarisht kërkohet që të bëhet miratimi i një shtojce në lidhje me këtë strukturë.

Pas fjalës së Drejtorit sjalën e merr Kryetari i Bordit, i cili shton një pyetje në lidhje me propozimin për ndryshim në nenin 16 paragrafi 2. Ai shton pyetjen nëse kjo do të sanksionohet në rregullore ose jo dhë më pas vazhdon duke thënë: “Duke qenë se kemi percaktuar këtu një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

raport 70% me 30%, ndodh që të neglizhohet raporti final. Jam dakort për kohën por ndoshta duhet të gjendet një formulë tjeter për t'u marrë këstë i fundit.

Znj. Dhuka shprehet: "Ka një mënyrë tjeter, nq.s ne i miratojmë në 6 mujorin e parë, këto fonde nuk ka rrezik që ato të digjen dhe po kështu edhe parapagesat, prandaj një opsjon është të jepim dy tipologji përqindjesh në periudha kohore 6 mujore."

Z. Kananaj thotë: "Meqënëse ju po ngrini këtë shqetësim propozoj të lihet rreth 50%. për arsyen 70% është një shumë e madhe për t'u dhënë si paradhënic."

Znj. Dhuka thotë: "Këtë shqetësim kam edhe unë, se dhënia e 70 përqind parapagesë bën që fondet të ikin kot për shkak se nuk ka menaxhimin e nevojshëm, ndaj mendoj që raporti 70% me 30% të bjerë dhe të vendosim që përpëra këstir të fundit të dorëzohet raporti final. Unë propozoj të vendosim 3 këste: njëri parapagim, një raport i ndërmjetëm dhe i treti raporti final pa përektuar përqindje."

Z. Thano thotë: "Kjo mund të bëhet vetëm nëse nuk merremi me thirrjet se në fakt afati për t'u realizuar kjo ide është shumë i shkurtër."

Z. Fuga shprehet: "I pari është parapagimi dhe mendoj që pas transhit të fundit të dorëzohet edhe raporti final."

Znj. Dhuka këmbëngul të bëhet pagesa me dy ose më shumë transhe, sipas kohëzgjatjes, periudhës dhe rëndësisë."

Ndërpriten këtu diskutimet në lidhje me këtë pikë dhe Kryetari i Bordit ngrë një pyetje tjeter në lidhje me ninen 14.

Z. Thano pyet se ç'ndyshim ka ndërmjet listës së fituesve dhe pikëvë të vlerësuara.

Z. Kananaj, ndërhyjn duke sqaruar se vlerësimet bëhen pa u shpjeguar dhe pa pike, ndaj ashtu si është në rregullore bëhet i pamundur apelimi, por që të mos kemi kontradikta të dukshme dhe të mundshme midis Bordit dhe grupeve të vlerësimit duke shtuar fjalën "mund" të shpallën pikët i japi mundësinë subjektit që me kërkesën e tij të marrë informacion mbi vlerësimin.

Znj. Dhuka ndërhyjn duke thënë: "Nuk më duket i drejtë përdorimi i fjalës shpallje."

Z. Merkoçi ndërhyjn duke u shprehur: "Ti detyrimisht e shpall, por që në të njëjtën kohë, nëqoftëse i interesuari kërkon të dijë pikët e veta, në hazë të kërkesës së tij, le të bëhet."



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Znj. Dhuka shprehet: "Për shembull, nëse një subjekt paraqet një kërkesë në lidhje pikët e vlerësimit, AMSHC është e detyruar të japë përgjigje mbi vlerësimin, ndërsa ne si Bord Mbikëqyrës nuk shpallim procedurat e vlerësimit, por ne shpallim me vendim vetëm listën e fituesve. Pra, Bordi nuk vlerëson, por vendos. Po përpinqem të ndaj vlerësimin nga miratimi i Bordit, prandaj sugjeroj të rishikohet neni. Vendimi i Bordit shpallet në çdo rast."

Z. Fuga ndërhyr: "Nëse Drejtori paraqitet me një listë ku thotë se për arsyen e ndryshme derisa disa subjekte kualifikohen e disa jo, Bordi nuk ka përsë të japë shpjegime, sepse bie dakord me Drejtorin."

Znj. Dhuka shton: "Biem dakord që arsyetimi negativ shkruhet në proces verbal, por rezultatet e procesit mund të njoftohen, jo të shpallen. Pra të zëvendësohet fjala "shpallen" me "njoftohen".

Anëtarët ranë dakord për sugjerimin e parashtruar.

Në vazhdim të diskutimit, Kryetari i Bordit hodhi idenë që Neni 9, Pika 2 nuk është i nevojshëm pasi nuk ka kuptim dhe duhet të hiqet.

Znj. Dhuka shprehet: "Ligji nuk kërkon panair idesh dhe thirrjet janë të paracaktuara aty ku janë priorititet e Qeverisë. Jam e mendimit të zëvendësojmë Panairin e Ideve me Konsultime Publike, siç janë të përcaktuara në Ligj."

Edhe për këtë pikë nuk pati kundërshtim nga anëtarët e Bordit.

Në vazhdim të mbledhjes u diskutua Neni 7, Pika 2/d dhe u ra dakord që të hiqet Pika 2/d, me kusht që në vertetimin e lëshuar nga organet tatimore të jetë përfshirë me të dhënat e sigurimeve shoqërore.

Bordi Mbikëqyrës ra dakord që bashkëngjitur Rregullores të shtohet edhe "Struktura organizative e AMSHC-së", në të cilën është integruar edhe struktura për KKSHC-në.

Duke vazhduar me rendin e ditës u hap diskutimi në lidhje me vendosjen e datës përkonsultimet publike dhe Bordi ra dakord që njoftimi mbi konsultimet të bëhet datë ___/___/2016. Në përfundim të fazës së konsultimeve, Bordi Mbikëqyrës do të mblidhet për të shpallur Thirrjen e radhës.

Në përfundim të mbledhjes Kryetari i Bordit Mbikëqyrës të AMSHC kujton edhe njëherë vendimet e marra në këtë mbledhje:




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren mbi Procedurat e Financimit me Grante në mbështetje të Shoqërisë Civile”
2. Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Brendshme të AMSHC-së (shtojcë në lidhje me integrimin e strukturës së KKSHC-së)
3. Hapja e periudhës së konsultimit për thirrjen e radhës

Ai rikujton gjithashtu se mbledhja e radhës do të zhvillohet ne datën pas përfundimit të fazës së konsultimit public për thirrjen e radhës.

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan dhe firmosën për pjesëmarrjen.

Mbledhja u mbyll në orën 16:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adrian THANO

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

Majlinda DHUKA

Nënkyetare e Bordit Mbikqyrës

Alban DUDUSHI

Anëtar

Albana Kociu

Anëtare

Aldo MERKOÇI

Anëtar

Endri FUGA

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtare

Ismail ADEMI

Anëtar

Kozara KATI

Anëtare